



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1703 / Prot.

Laç, më 28 . 03 .2023

VENDIM

Nr. 22 datë 24/03/2023

**“MBI SHTIMIN E EMRIT TË NJË NXËNËSI TË ARSIMIT BAZË PËR PËRFITIM
GJYSËM BURSE PËR VITIN MËSIMOR 2022 – 2023”**

Bazuar në ligjin Nr. 139/15, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” të ndryshuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, shkresën Nr. 6478/54 Prot., datë 11.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023” 30 (tridhjetë) bursa, si dhe referuar shkresës Nr. 231 Prot., datë 17.03.2023, pika 3 të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin “Për disa ndryshime në shkresën Nr. 1215 Prot. datë 16.12.2022 “Kërkesë për mbështetje financiare”, për arsye të nje defekti teknik (kapërcim numri rendor në listë) nxënësi Alesio Afrim Berisha i shkollës 9-vjeçare “Fran Pal Piroli” Zhejë nuk është pasqyruar në listen e nxënësve që përfitojnë gjysëm burse për vitin mësimor 2022-2023. Pas propozimit nga ZVAP Kurbin, drejtorja e arsimit dhe Kryetaria e Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI;

Të miratojë emrin e nxënësit _____, shkolla 9-vjeçare “Fran Pal Piroli” Zhejë për përfitim gjysëm burse për vitin mësimor 2022-2023.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë.

>ZVAP Kurbin

>Drejtorja e arsimit .

>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA



KRYETARJA E KESHILLIT

Edlira LLESHI